



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

**AD.GJTH.GJL.nr.03/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtorin profesional Faton Lakna, duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga ankuesi F. S. [redacted] nga Gjilani, të datës 15.05.2023, për iniciimin e procedurës disiplinore, ndaj gjyqtarit Veli Kryeziu - gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 18.05.2023, morri këtë:

**AKTVENDIM**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paraqitur nga F. S. [redacted], me vendbanim në Rr. "Mbreti Bardhyl", pa nr, në Gjilani, e datës 15.05.2023, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit V. K. [redacted] - gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Gjilani.

**Arsyetimi**

Me datë 15.05.2023, ankuesi F. S. [redacted], në këtë gjykatë ka paraqitur ankesë, drejtuar Kryetarit të Gjykatës, duke theksuar se në Gjykatën Themelore në Gjilani – Departamenti i Përgjithshëm është në procedurë e sipër lënda penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani, ndaj të pandehurit H. M. [redacted], mirëpo si palë e dëmtuar konsideroj se kohëzgjatja e paaryeshme e kësaj procedure është një dëm serioz për garancinë procedurale të të drejtës për gjykim të drejtë dhe se një vonesë e tillë, në masë të madhe më ka dëmtuar besimin e paluhatur që kamë pasur në drejtësi e poashtu kjo vonesë rrezikon që edhe vepra penale të parashkruhet qëllimshëm, ashtu që

konsiderojë se në këtë çështje nuk janë duke u ndërmarrë veprimet e nevojshme në kryerjen e detyrave zyrtare siç kërkohët me ligj për trajtimin e lëndës në kohë.

Andaj nga arsyet e cekura si më lartë, i njejtë ka kërkuar nga kryetari i kësaj gjykate që të ndërmarrë masat e nevojshme procedurale me qëllim të përmbylljes në mënyrë meritore dhe mbrenda afateve të parapara ligjore sipas Kodit të Procedurës Penale, në çështjen penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, kundër të pandehurit H. M., me vendbanim në Rr. "Vëllezërit Frashëri", nr.35 në Gjilan.

Kryetari i Gjykatës pas pranimit të ankesës nga ankuesi F. S. nga Gjilani, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ku nga gjyqtari i çështjes V. K., më datën 15.05.2023, ka kërkuar deklaratë me shkrim lidhur me statusin e kësaj lënde penale me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të palës ankuese.

Gjyqtari V. K. me deklaratën e datës 16.05.2023, drejtuar kryetarit të kësaj gjykate, ka theksuar se lënda P.nr.588/2020, kundër të pandehurit H. M. nga Gjilani, për shkak të veprës penale nga neni 320 i KPRK-së, është pranuar nga gjyqtari S. M., pasi që i njejtë gjyqtar ka kaluar në Departamentin për Krime të Rënda dhe se lidhur me këtë çështje unë për datën 17.03.2021, e po ashtu edhe për datën 21.04.2021, të gjitha palëve i'u kam dërguar ftesa për shqyrtim gjyqësorë, mirëpo edhe pse palët, ftesat i kam pranuar në mënyrë të rregullt të njejtë nuk janë paraqitur në seancë, kurse po të njejtën ditë më datë 21.04.2021, kamë lëshuar Urdhëresë Policisë së Kosovës që i pandehuri H. M. të sillët në mënyrë të detyrueshme në gjykatë e cila urdhëresë është ende në fuqi.

Tani kjo lëndë do të procedohet për shqyrtim për muajin korrik dhe se ndaj të pandehurit të lartëcekur do të përsëritet edhe njëherë urdhëresa për sjellje të detyrueshme.


Kryetari i gjykatës, pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës së ankuesit F. S. lidhur me pretendimet e të njejtit për shkelje të mundshme disiplinore nga ana e gjyqtarit të çështjes, si dhe pas analizimit të deklaratës me shkrim të dhënë nga ana e gjyqtarit V. K. ka arritur në përfundimin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkelje të mundshme disiplinore nga ana e gjyqtarit, nga se sipas deklaratës së të njejtit dhe nga shkresat e lëndës P.nr.588/2020, rezulton se gjyqtari ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale të parapara sipas Kodit

të Procedurës Penale të Kosovës, me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështje penale, ashtu që i njëjti ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 21.04.2021, por edhe përkundër se palët janë ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës, të njëjtit nuk janë paraqitur në seancën e lartëcekur, andaj gjyqtari i çështjës me aktvendim procedural, ka shtyer shqyrtimin fillestar për datën 10.06.2021, dhe në të njëjtën kohë ka lëshuar urdhëresë Policisë së Kosovës që i pandehuri H. M. të sillët forcërisht në gjykatë, mirëpo sipas shkresave të lëndës rezultoi se kjo urdhëresë nuk është realizuar nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, ku për këtë çështje, gjyqtari tashmë ka caktuar shqyrtimin gjyqësorë për muajin korrik të këtij viti.

Andaj, nga arsyet e cekura si më lartë dhe duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, kryetari i kësaj gjykate ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i Gjykatës

Venhar Salihu



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Ky aktvendim i dorëzohet:

1. Gjyqtarit H. K.,
2. Parashtruesit të ankesës,
3. KGJK-së
4. Një kopje të ruhet në dosje.